

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Angli - Ish-qendrën tregtare dy shqiptarë e kthejnë në "shtëpi bari", policia i heq nga duart prodhimin me vlerë 1.3 milionë paundë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/angli-ish-qendren-tregtare-dy-shqiptare-e-kthejne-ne-shtepi-bari-policia-i585570
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 10:01:56 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 10:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9fd0b67625c112b1fab231af624eb592cf1d68a12e432bba2562435135dcfdaa
TEKSTI	0217f4e017c61219ad6db54e0a6cef993688be9f05e9db5a6ba60895233e4c0d
PAMJA	cff1488ca95a79680ba0fc55fc2061eac1183538e9e9a3dd8c3e1519402f8be6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9e2e35bfbfe5d63efbdb720ccf8fa463db4763f10263b4bb7d9f0eaebaed004d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9e2e35bfbfe5d63efbdb720ccf8fa463db4763f10263b4bb7d9f0eaebaed004d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1e Nga denimi në Shqipëri te arratisja spektakolare në Greqi, kush është i burgosur shqiptar që i iku policisë grekeArrestohet në Athinë i shumëkërkuari shqiptar. Hita jep detajetJohn Goci konkurroi fundit

Angli - Ish-qendrën tregtare dy shqiptarë e kthejnë në “shtëpi bari”, policia i heq nga duart prodhimin me vlerë 1.3 milionë paundë

12 Shtator 2026, 12:50Kronika TEMA



Angli - Ish-qendrën tregtare dy shqiptarë e kthejnë në

Një godinë dy katëshe ku prodhohej lëndë narkotike është zbuluar brenda një ish-dyqani të rrjetit BHS në qendër të Slough të Anglisë, ku policia gjeti më shumë se 1,700 bimë kanabisi.

“ESN Report” njofton se vlera e drogës së prodhuar nga impianti është përlogaritur në rreth 1.3 milionë paund në tregun me pakicë.

Policia ndërhyri në ambientet e ish-dyqanit më 28 janar 2026, pas dyshimeve se ndërtesa e lënë bosh prej vitesh po përdorej për kultivimin e kanabisit.

Gjatë operacionit, oficerët arrestuan brenda fabrikës Ajet Begun, 40 vjeç, nga Palmers Green në Londër, dhe Aryan Turya, 27 vjeç, pa vendbanim të përhershëm.

Në ambientet e ndërtesës u gjetën më shumë se 1,700 bimë kanabisi, në faza të ndryshme të rritjes. Sipas përlogaritjeve të policisë, bimët mund të prodhonin rreth 150 kilogramë kanabis.

Vlera e drogës u përlogarit në 1,288,020 paund në tregun me pakicë, ndërsa në tregun e shumicës vlera arrinte rreth 525,000 paund.

Dy të arrestuarit pranuan fajësinë për veprën penale të prodhimit të një droge të kontrolluar të Kategorisë B. Ata u dënuan më 21 gusht 2026, në Gjykatën e Kurorës në Reading, me nga një vit e dy muaj burgim.

“ESN Report” raporton se hetimet vijnë për të përcaktuar nëse fabrika kishte lidhje me rrjete më të gjera të krimit të organizuar.

Ndërtesa kishte mbetur bosh që prej vitit 2016, kur rrjeti BHS mbylli dyqanet e tij. Zbulimi ka rikthyer vëmendjen te përdorimi i ambienteve tregtare të braktisura nga grupet kriminale, veçanërisht në zona urbane dhe në rrugë kryesore ku aktiviteti i paligjshëm mund të fshihet pas një fasade të zakonshme.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Arrestohet në Athinë i shumëkërkuari shqiptar, Hita jep detajet](#)

11:50 Kronika

[Tronditet Kamza, shpërthim me tritol në derën e shtëpisë së një 36-vjeçari](#)

10:08 Kronika

[Atentati ndaj Agron Pukës në Rrilë, Gjykata shuan masat e arrestit për tre të dyshuarit](#)

09:40 Kronika

[Kapen në flagrancë tre persona në Fier, dyshohen për vjedhje banesash dhe posedim droge \(VIDEO\)](#)

09:20 Kronika

[Aksidenti në Porto Palermo, përmbysset automjeti! Tre persona të plagosur](#)

08:20 Kronika

[Zjarret/ Ministria e Mbrojtjes: Pesë vatra aktive, asnjë rrezik për zonat e banuara](#)

21:54 Kronika / 1 koment

[Operacioni misterioz në Greqi, kush është trafikanti i kokainës që u arrestua dhe kërkohet nga Shqipëria për vrasje?](#)

20:40 Kronika

[Ishte duke punuar në një shtyllë tensioni, humb jetën elektrikisti në Marglliç te Patosit! Policia shoqëron në Komisariat 4 persona](#)

19:50 Kronika

[Para nisjes së vitit shkollor, Hita shpalos prioritetet e Policisë në Tiranë, Korçë e Dibër: Luftë krimit dhe drogës, risim kontrollet pranë shkollave!](#)

18:20 Kronika

[Goditen 3 raste të prostitucionit në Tiranë, në pranga 4 persona](#)

15:10 Kronika / 2 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[PISA, hakmarrja europiane për mësueso-fobët shqiptarë](#)

16:18 Politika / 41 komente

[Aerporti Ndërkombëtar i Tiranës investon 7 milionë euro](#)

13:45 Sociale /3 komente

["Në emrin tim flas vetëm unë"/ Rama për arrestimin e Agas...](#)

22:46 Politika /9 komente

[Ullishtja kombëtare e pronësisë shqiptare](#)

17:00 Editorial /17 komente

["Për dosjet e qytetarëve vite pritje, për pagat e veta Gj...](#)

16:23 Politika /48 komente

Blog Tema

[John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?](#)

11:40 Blog

[Haga, midis maktheve dhe paranojave](#)

21:25 Blog /2 komente

[Haga, midis maktheve dhe paranojave](#)

21:00 Blog /1 koment

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 [Powered by Tomorrow.io](#)

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

- 
- 
- 
- 
- 

Built and Monetized by

- [Politika](#)
 - [Kronika](#)
 - [Editorial](#)
 - [Blog](#)
 - [Bota](#)
 - [Sport](#)
 - [Shëndeti](#)
 - [Turizëm](#)
 - [Kontakt](#)
 - [Te dhënat personale](#)
 - [Cookies](#)
- [Sociale](#)
 - [Ekonomia](#)
 - [Antena](#)
 - [Rajoni](#)
 - [Kulturë](#)
 - [Lifestyle](#)
 - [Dossier](#)
 - [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by